



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.12.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Vizitë pune e Komisionit në Muzeun Historik Kombëtar.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Almira Xhembulla, Adelina Rista dhe Bujar Çela.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Sezai Rrokaj.

Në prani:

Dorian Koçi –Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi- Mirëmëngjesi të gjithëve!

Shumë faleminderit, kolegë, që keni ardhur në hapësirën e Muzeut Kombëtar!

Siç e kishim vendosur, gjatë këtij muaji do të zhvillojmë disa aktivitete në terren për të bërë kontrollin tonë parlamentar dhe për të parë se cila është ecuria e institucioneve që janë nën varësinë e komisionit tonë.

Zoti drejtor, zakonisht, kur vijmë në të tilla aktivitete, mundohemi që të jemi të gjithë anëtarët e komisionit dhe kjo vizitë të marrë kuptim. Prandaj, dua të pyes zotin Fidel në qoftë se jemi gati të fillojmë me diskutimin dhe nëse kuorumi është i plotë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli- Kuorumi është i plotë dhe ne mund të vazhdojmë mbledhjen.

Unë vazhdoj të them që ndiej keqardhje për opozitën që nuk është e pranishme, sepse kemi bërë shumë debate në komision për të mbështetur trashëgiminë kulturore dhe të gjitha këto *sajte* të rëndësishme, që i japin një mbështetje dhe një imazh vendit tonë, por përsëri opozita bojkoton. Kështu që ne mund të vazhdojmë mbledhjen e komisionit.

Milva Ekonomi Faleminderit!

Ne në gjitha këto lëvizje që kemi bërë, nëpërmjet mundësive që na ka dhënë edhe më parë OSBE-ja dhe vetë parlamenti, jemi përpjekur që kudo që kemi shkuar, si në Berat, Butrint, Gjirokastër, Krujë dhe Durrës, të hartojmë një lloj bashkëbisedimi që ka disa pyetje të përbashkëta. Për shembull, me numrin e vizitorëve që ju keni pasur këtë vit, me projekte të rëndësishme që keni pasur gjatë këtij viti, të ardhurat dhe mbështetjen që keni pasur nga aktiviteti, të shikojmë se si keni bashkëpunuar ju me qeverinë lokale, çfarë ka bërë bashkia në këtë rast dhe, pastaj të na rekomandoni ne disa nga nevojat që keni dhe që mund të përkthehen në iniciativa ligjore ose në nisje të një bashkëbisedimi me Ministrinë e Kulturës, lidhur me të ardhurat dytësore apo me klasën e pagave të punonjësve që punojnë në institucionin tuaj. Kështu që do të ishte mirë të na bënit një përshkrim të këtyre çështjeve.

Dorian Koçi- Ju faleminderit dhe mirë se keni ardhur!

Është një kënaqësi e veçantë t'ju kemi këtu. Unë kam pasur fatin të jem pjesë në takimin që bëmë në Berat, nga ku dolëm edhe me disa përfundime të rëndësishme. Gjithashtu, kam qenë në komisionin parlamentar vitin e kaluar, për të diskutuar për buxhetin, që edhe ai ishte shumë i rëndësishëm.

Siç e dini, ky vit ka qenë viti i një bumi të madh turistik në Shqipëri, i ardhjes së vizitorëve të huaj, që u realizua me përfshirjen e shumë faktorëve dhe aktorëve që janë pjesë e qeverisjes qendrore, qeverisjes lokale dhe institucioneve të kulturës.

Një numër i madh vizitorësh nuk mund të arrihej të menaxhohej nëse nuk do të ishim të gjithë së bashku dhe nëse nuk do të ishte shpallur turizmi si një prioritet i qeverisë shqiptare dhe, në këtë aspekt, edhe Muzeu Historik Kombëtar, si një nga vendet që pasqyron historinë e popullit tonë, kulturën dhe trashëgiminë e tij ka qenë një nga vendet më të vizituara. Ne jemi munduar, me takime të drejtpërdrejta dhe me kompani turistike, të cilat i kemi parë si bashkëpunëtorë të drejtpërdrejtë, për të bërë të mundur që ky numër i madh turistësh, që vjen në Shqipëri, të ketë mundësinë të reflektojë dhe të vijë edhe në Muzeun Historik Kombëtar.

Një sfidë tjetër jona ka qenë rritja e numrit të vizitorëve vendas, sepse është e vërtetë që kemi të huajt, të cilët vijnë për të parë pjesë të trashëgimisë, por atë që ne duam të arrijmë është pikërisht një ndërtim dhe një sinergji e modulit kulturor dhe shpirtëror të shqiptarëve. Për këtë arsye, ne kemi ngritur edhe disa programe mbështetëse në kuadër të edukimit përmes kulturës, ku zhvillojmë dy programe mujore: “Arkeologu i vogël”, që tashmë është një nga markat tona më të fuqishme, dhe “Muzeu im”, në të cilin vijnë vizitorë të ndryshëm dhe shumë aktivitete të tjera.

Për ta ilustruar numrin e vizitorëve, nga periudha janar-nëntor ne kemi pasur në Muzeun Historik Kombëtar rreth 60 mijë vizitorë, që është një rritje me 11 % nga viti 2017 dhe një rritje pothuajse prej 72,3 % në periudhën janar-nëntor të vitit 2016. Pra, ajo që ne mendonim në fillimet tona, që ky *saj*t kishte në vitin 2014 20-25 mijë vizitorë, tashmë ka arritur në numrin 60 mijë, që është një trend, të cilin ne duam ta mbajmë dhe ta vazhdojmë. Kjo është përkthyer edhe në të ardhurat që ne kemi realizuar. Pse këmbëngul në të ardhurat?! Sepse *saj*ti i Muzeut Historik Kombëtar merr mbrapsht 30 % të të ardhurave që ne administrojmë. Është e vërtetë që kemi një limit buxhetor, i cili është në masën 26 milionë lekë të vjetër, pra nuk mund ta kalojmë dhe vjet Ministria e Kulturës nga 20 milionë na e rriti në 26 milionë lekë të vjetër, që do të thotë se në bazë të performancës sonë ky vit....

Ismet Beqiraj –Çfarë janë këto 26 milionë?

Dorian Koçi - Këto janë të ardhura, të cilat ne i marrim dhe i administrojmë nga 30%-shi, nga biletat dhe nga të ardhurat dytësore, si: sallat dhe ekspozitat, të cilat administrohen..

Milva Ekonomi- A ka shpenzime rrjedhëse në buxhet?

Dorian Koçi - Ne kemi shpenzime rrjedhëse, sepse në fillim jepen 135 milionë lekë të vjetra nga buxheti.

Ismet Beqiraj – Sa rroga, sa paga?

Dorian Koçi - Gjithë rrogat, pagat, pagesën e energjisë elektrike dhe pagesën e rojeve të sigurisë, por me të ardhurat tona kemi bërë të mundur ta realizojmë pagesën e energjisë, pagesën e ujit dhe të realizojmë disa aktivitete të rëndësishme dhe disa botime, disa konferenca shkencore.

Për herë të parë Muzeu Historik Kombëtar, me bashkëpunimet që ka pasur me Muzeun e Bukureshtit, arriti të kishte në fillim të sezonit turistik në Shqipëri një ekspozitë që i dedikohej Tiranës, e cila ishte: “Hello, my name is Tirana”, i cili u krijua në pallatin “Sucu”, që zoti Velaj e di, sepse ka qenë aty. Ai është një nga *sajtet* më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të kryeqytetit rumun, i cili bëri të mundur që ne të kishim aty një ekspozitë për rreth tri javë.

Në kuadër të “Vitet të Skënderbeut”, kemi qenë dy herë në Prishtinë, në Shkup dhe në Prizren. Ekspozita “Unë jam shqiptar” ka qenë pjesë e kalendarit të përbashkët midis ministrive të Kulturës dhe është përfunduar në muajin gusht në Prishtinë, nga atje ka shëtitur në Prizren dhe në Tetovë, në një datë simbolike 14 tetor, kur është hyrja e Hasan Prishtinës dhe marrja e Shkupit në kuadër të kryengritjes së përgjithshme. Kjo ekspozitë është hapur në Shkup me pjesëmarrjen e personaliteteve më të larta të jetës akademike dhe politike të shqiptarëve, por edhe maqedonasve në Shkup.

Fidel Ylli – Çfarë është pasqyruar?

Dorian Koçi – Ekspozita “Unë jam shqiptar” është një ekspozitë e diasporës shqiptare historike, e cila fillon që me shpërnguljet e para të shqiptarëve në Greqi me arvanitasit dhe me arbëreshët në Italinë e Jugut, vazhdon me ndërtimin e kolonive shqiptare në Rumani, në Bullgari, në Egjipt, në Argjentinë, në Amerikë dhe me figurat më të shquara të diasporës së sotme shqiptare. Kjo është bërë për të përgatitur, pak a shumë, mundësinë e lidhjes me Ministrinë e Diasporës, pasaportën kulturore më të mirë të shqiptarëve në botë. Po kështu, ekspozita i është dhënë diasporës sonë në Londër, e cila në datën 28 nëntor ka pasqyruar një ekspozitë për Pavarësinë, e cila është e përgatitur e gjitha nga Muzeu Historik Kombëtar, u është dhënë vetëm për t’u printuar. Po kështu edhe një për diasporën shqiptare për të përgatitur samitin e diasporës, që do të jetë më 2 mars në Tiranë.

Një pjesë e tjetër e rëndësishme kanë qenë programet dhe disa pjesë të përkujtimit të datave të rëndësishme historike dhe kulturore që ka pasur vendi. Ne kemi qenë shumë aktivë për “Vitin kombëtar të Skënderbeut”, që në datën 17 janar me hapjen e një ekspozitë në Tiranë, që aktualisht gjendet në Prishtinë, ku pati një impact, dhe për të përmbyllur ciklin mendojmë ta vazhdojmë ekspozitën e diasporës në muajin janar dhe shkurt në Ulqin. Jemi në kontakt me

arbëreshët e Italisë së Jugut, që kjo ekspozitë të udhëtojë edhe aty, sepse janë të pasqyruara të gjitha fushat kryesore.

Kemi përkujtuar Lidhjen Shqiptare të Prizrenit në 140 vjetorin e saj, në një ekspozitë të veçantë në Muzeun Historik Kombëtar. Kemi përkujtuar Kongresin e Manastirit, në një ekspozitë të veçantë dedikuar kësaj ngjarjeje kaq të madhe. Në fillim të janarit kemi realizuar një projekt shumë të rëndësishëm, viti kulturor Austri-Shqipëri u hap në Muzeun Historik Kombëtar, ku të gjitha personalitetet më të rëndësishme të vendit morën pjesë në një konferencë “Shqipëria dhe Austro-Hungaria”, e cila do të finalizohet me një botim në shqip dhe gjermanisht, që është një hap i mirë, ku ambasadori Satler, me të cilin kemi marrëdhënie shumë miqësore, na ka premtuar se ky botim do të jetë edhe në bibliotekat e ndryshme të Vjenës dhe në vitin që vjen ai do të jetë një promotor i lidhjes së drejtpërdrejtë për shkëmbimin e eksperiencës së stafëve me muzetë e Austrisë, që është një nga vendet lider në këtë fushë.

Ne u kemi kushtuar vëmendje edhe objektivave të qeverisë, që është edukimi përmes kulturës, ku janë organizuar disa aktivitete nga Muzeu Historik Kombëtar, që janë shpërndarë në muzetë e tjerë lokalë: “Një ditë në muze”, “Arkeologu i vogël”, “Muzeu im”, “Një orë mësimi në muze”, “Vizato historinë” dhe, së fundi, “Takohemi për një libër”, ku do të ftohen figura të shquara të historiografisë shqiptare, që do të lexojnë libra, për të pasur një lloj mundësie që edhe brezi i ri të adoptohet dhe të ketë një tjetër përjasje.

Një tjetër gjë, që ne e kemi konsideruar të vazhdueshme, është krijimi i një *network-u* të përbashkët të shtëpive muzeale dhe të qendrave muzeale të shqiptarëve në rajon dhe për këtë arsye ne jemi në lidhje me Muzeun e Kosovës që të organizohet vitin e ardhshëm dhe në vazhdim. Kjo iniciativë është ndërprerë për shkak të ndërprerjes së mandatit të një drejtori, pra çështje administrative, të cilat nuk janë zgjidhur ende nga qeveria e Kosovës, për të bërë takime, qoftë në Tiranë apo qoftë në Prishtinë, të përditshme, me të gjitha qendrat muzeale të muzeologëve shqiptarë, në mënyrë që të krijojmë një dokument të përbashkët dhe të bëjmë të mundur të ecim më përpara në fushën e muzeologjisë.

Dua të falënderoj në mënyrë të veçantë komisionin për mbështetjen që ka dhënë për kalimin e ligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, dhe miratimin e tij, sepse na jepet hapësira, tashmë me akte nënligjore, të cilat do të hartohen, që Muzeu Historik Kombëtar të marrë gradualisht rolin udhëheqës në muzeologji, në krijimin e një qendre. Pra, nëse më parë nuk ka qenë kërkimi shkencor pjesë përbërëse dhe integrale, tashmë ne do të kërkojmë, qoftë nga Ministria e Kulturës, që një pjesë e të ardhurave tona të kalojnë për kërkimin shkencor, në mënyrë të tillë që kjo të vijë dhe tek ajo që zonja Ekonomi tha, të rishikimi dhe rivlerësimi i pagave. Domethënë, punonjësit që do jenë në kërkim shkencor të arrijnë të marrin pagat sipas

gradave të tyre shkencore, qoftë nëpërmjet kontrollit të Ministrisë së Kulturës, qoftë të qendrave të tjera kulturore, qoftë të Ministrisë së Arsimit. Pra, të shikohet edhe produkti final i këtyre rezultateve që ne dëshirojmë të arrijmë.

Na është dashur shumë punë të për të kaluar në një koncept tjetër. Le të jemi të sinqertë, historiografia në Shqipëri, pak a shumë, i ka rënë pak më qafë muzeologjisë. Për çfarë arsye?! Sepse historianët i shikojnë të gjitha gjërat gjithmonë me dokument. Nëpërmjet objekteve ne duam që të fillojmë dhe të rrëfejme historinë e Shqipërisë, sepse bëhet më e thjeshtë dhe më e absorbueshme edhe për të huajt që vizitojnë Shqipërinë, sepse *sajtet* tona flasin shumë më tepër sesa një dokument, i cili është në gjuhën shqipe qoftë i përkthyer, por që nuk ka arritur. Këtë gjë kemi mundur ta arrijnë në bashkëpunime shumë të suksesshme që kemi qoftë me ambasadën austriake, qoftë me ambasadën spanjolle, qoftë me ambasadën britanike apo edhe me faktorë të ndryshëm. Jemi në momentin e ngritjes së asaj që quhet “Miqte e muzeut”, një institucion shumë i rëndësishëm, që pothuajse është në të gjithë muzetë e botës, ku ftojmë biznesmenë të rëndësishëm të vendit që kanë dëshirë dhe duan të investojnë në trashëgiminë kulturore. Për shembull, siç vijnë letrat e Shagall-it në Shqipëri, që është një gjetje shumë e arrirë, që shumë veta nëpër vende të ndryshme, madje edhe në Paris po të shikojnë, nuk arrijnë dot që ta shikojnë këtë ekspozitë të përfshirë në atë kohë. Kjo është bërë në bazë të bashkëpunimit të biznesmenëve shqiptarë. Një tjetër gjë e rëndësishme ishte sjellja e hartës. Ne jemi në marrëveshje me qeverinë italiane dhe ambasadori italian na ka premtuar që një nga hartat e Skënderbeut, që u ekspozua në Kryeministri, do të jetë pikërisht në mënyrën e rikonceptimit të Muzeut Historik Kombëtar. Atëherë, forumi i ri, që do të ndërtohet, do të bëjë të mundur që nëpërmjet anës ligjore të dhurimit, shumë pjesë të rëndësishme, që edhe nga shqiptarët që janë në diasporë, të bëhen të mundura dhe të dhurohen, sepse hapësirat ligjore që ishin, para se të miratohej ligji, ishin shumë të frikshme dhe të tmerrshme. Dikush që vinte dhe dhuronte qoftë edhe 1 mijë dollarë në Muzeun Historik Kombëtar, një shqiptar nga diaspora, do t’i duhej të plotësonte diku te 20 dokumente, akte dhurimi, marrje llogarish, mbajtje në bankë, të cilat më tepër e mërzisnin dhuruesin sesa me të vërtetë zgjidhte një punë. Kurse nëpërmjet këtij forumi, me hapjen e një llogarie të veçantë të monitorueshme, kjo do të bëhet e mundur pa pengesat e sipërpërmendura.

Fidel Ylli – Zoti drejtor, që të mos zgajtemi, sepse kohën edhe ju e keni të pakët, se keni takim, por edhe ne kemi një takim tjetër, ndoshta si anëtarë komisioni do të donim disa gjëra në lidhje me stafin, mënyrën e menaxhimit dhe çfarë ka nevojë ky institucion kaq i rëndësishëm, që për mendimin tim donte një status të veçantë, pra Muzeu Kombëtar.

Në të gjitha *sajtet* ku kemi shkuar, si në Krujë, si në Butrint, si në Gjirokastër dhe në Durrës, duke i krahasuar me hyrjet në muze, më duket se Muzeu Kombëtar ka më pak vizitorë. Çfarë duhet të bëni ju më shumë ose çfarë mbështetje doni nga ne, që ky Muze të bëhet atraksion për të gjithë turistët që vijnë, por edhe për shqiptarët, që ndoshta e kanë si pikë takimi, por nuk kanë hyrë brenda për ta parë Muzeun siç duhet? Pra, çfarë duhet të shtojmë ne më shumë në këto pavijone, përveç këtyre ekspozitave, siç ishte rasti i sjelljes nga Vjena i shpatës dhe i disa gjërave të Skënderbeut?

Dorian Koçi – Ne konstatojmë se *sajte* të tilla, si Butrinti, Apolonia apo Berati, që ju i keni vizituar me të drejtë, janë *sajte* të hapura në natyrë dhe janë pjesë drejtpërsëdrejti e ofertës turistike që afrohet dhe shkon. Unë e thashë edhe në fillim, besoj se sfida jonë më e rëndësishme është rritja e numrit të vizitorëve vendas, që në Muzeun Historik Kombëtar ka shkuar rreth 19 mijë veta, gjë që nuk ka ndodhur më parë, nëpërmjet ekspozitave të ndryshme dhe përkujtimeve që kemi bërë. Ajo që ne dëshirojmë do të ishte që në një përvjetor të rëndësishëm, siç ishte Viti i Skënderbeut, të mos përqendrohemi vetëm në një aspekt. Për shembull, dy *sajte* të rëndësishme të Skënderbeut, Muzeu Historik Kombëtar në Krujë dhe Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë, nuk patën një mbështetje të rëndësishme ose propozimet përkatëse që ne kaluam, nuk u pasqyruan, por kaluan nëpërmjet një komisioni qeveritar. Për shembull, e gjithë Konferenca Albanologjike që u bë, ishte që propozimi të bëhej në pavjonin e Skënderbeut, por u kalua te Pallati i Kongreseve. Kjo është një nga arsyet.

Për shembull, këtë vit ne kemi 100-vjetorin e vdekjes së Isamil Qemalit, që është një ngjarje madhore. Ne do të dërgojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, është themeluesi i shtetit shqiptar dhe ne do të çojmë propozimet përkatëse në Ministrinë e Kulturës dhe në qeveri, në mënyrë që të jemi pjesa fokale.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Velaj – Meqenëse jemi aty, unë kam biseduar me Andrea Romicin, kryetari i bashkisë së Peruxhias, për të vendosur një bust të Isamil Qemalit në Peruxha.

Bujar Çela – Duke falënderuar zotin Velaj për nismat përtej kufirit, që janë të një niveli shumë të lartë, këtë gjë mund ta kuptojë vetëm zoti Ylli, sepse unë dua kohë që të arrij aty, jam plotësisht dakord me bukurinë e Deas, si bukuri e femrave shqiptare, sepse ne kemi shoqet tona që i shikojmë përditë dhe janë yje të vërteta, por, si Vit i Skënderbeut, megjithëse keni hapur një pavijon hyrje, unë doja që të ishte skulptura e Skënderbeut në atë pozicion. Nuk e di pse, mbase e ka penguar shoku Ismet?!

Faleminderit!

Dorian Koçi – Faleminderit, ne e menduam dhe gjatë gjithë vitit...

Fatmir Velaj – Është mirë që të vihet re, se që kur doktor Dorian Koçi ka ardhur në drejtimin e Muzeut Historik Kombëtar, kemi një ngritje të fizibilitetit, jo vetëm të biletarisë, por edhe të ardhjes së grupeve arsimore, studimore, të universitetit, të klasave nga vende të ndryshme. Sado që gjithmonë jam i mendimit se vendi i Dorianit këtu, është vend i gabuar, sepse unë Dorianin e dua ambasador të Shqipërisë në Kajro të Egjiptit. Doriani është një egjiptolog i famshëm dhe ka studiuar në Kajro. Meqenëse Eduart Sulos i mbaron mandati së afërmi, unë doja që të shkonit ju atje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Musa Ulqini – Përtej këtyre gjërave të mençura që thatë, unë kam një gjë praktike. Kemi dëgjuar që këtë institucion e pret një investim i madh, sepse këtu ka nevojë për një ndërhyrje të madhe, thelbësore, me fonde, për të ndryshuar infrastrukturën, teknologjinë e ngrohjes dhe gjithçka që lidhet me të, për ta kthyer në një institucion...

Dorian Koçi – Ky do të jetë një nga investimet më të mëdha dhe është shpallur si prioritet i qeverisë shqiptare. Kryeministri në shtator, në daljen e parë publike, tha: “Muzeu Historik Kombëtar dhe galeria e arteve, që tashmë është bërë Muzeu i Arteve të Bukura, do të jenë dy investimet më të mëdha të qeverisë shqiptare”. Ndërkohë është ngritur grupi i punës dhe në buxhetin që i kaluat Ministrisë së Kulturës, 400 milionë lekë të vjetër, ishin pikërisht një shtesë për Muzeun Historik Kombëtar. Grupi i punës është ngritur me përfaqësues të të gjithë institucioneve tona shkencore, duke filluar nga Fakulteti i Tiranës, Katedra e Historisë apo Akademia e Studimeve Albanologjike. Unë vetë jam pjesë e grupit të punës, së bashku me 4 anëtarë të tjerë nga Ministria e Kulturës, të cilët do të shikojnë produktin që do të dalë për rikonceptimin e linjës muzeale. Ka pasur debate, këto kalojnë edhe në Këshillin Shtetëror të Muzeumeve, për ruajtjen dhe shtimin e kësaj linje muzeale, sepse, për hir të së vërtetës, për këtë kanë punuar kolosët e shkencës shqiptare, pavarësisht ideologjisë, Aleks Buda, Stefanaq Pollo, Kristo Frashëri dhe shumë njerëz të tjerë. Atëherë, në dhjetor do të jepet ky produkt. Ne do ta rishqyrtojmë mbi bazën e atij produkti, që do të jetë linja muzeale, e cila do të vlerësohet nëse do të jetë varianti final. Pra, do të shikohen dhe do të bëjmë parashikimet buxhetore për ndërtimin dhe kthimin e kësaj godine në një godinë funksionale, e cila do të ketë dy gjëra kryesore.

Së pari, nuk do të ketë më një postbllok midis sheshit dhe Rrugës së Durrësit, por do të jetë kati i parë, me një ambient të hapur me xham, ku do të jenë zyrat e administratës, do të jetë biblioteka e Muzeut Historik Kombëtar, do të jetë një vend modern për t’u shërbyer.

Nuk diskutohet që rrjeti elektrik, rrjeti ujqor, të cilët janë shumë të konsumuar, si dhe ngrohja e ftohja të jenë sipas të gjithë parametrave. Do të pasurohet me objekte të shumta të gjendura, të cilat janë në bodrumet e Institutit të Arkeologjisë. Mund të themi se kultura ilire është më pak e përfaqësuar se kultura latine dhe kultura helene. Kështu që do të ketë një prurje edhe më të rëndësishme. Zakonisht ne jemi nën presionin se arkeologët duan një muze arkeologjik mesjetar, por ky do të ketë konceptin gjermanik, ashtu siç është ndërtuar, të muzeve historike kombëtare. Qeveria do të shohë kostot, të cilat, për hir të së vërtetës, janë të mëdha. Flitet diku te 12-13 milionë euro që të dalë një projekt. Kjo do të thotë që nuk do të vihet më dorë dhe do t'u lihet brezave për shumë vjet. Pra, do të ketë vetëm kosto mirëmbajtje.

Në radhë të dytë, ne jemi duke parë problemin se çfarë do të bëhet. Deri tani kemi rëndë dakord që të mos mbyllet, siç u bë në variantin e Serbisë. Serbisë iu deshën nga viti 2000 deri në vitin 2018 që ta rihapte muzeun e vet historik, pra 18 vjet, me një investim prej 14 milionë eurosh. Pra, ishte i mbyllur, njerëzit punonin me një staf të reduktuar. Kjo nuk të çonte askund. Ne kemi menduar që ky rikoncepim, për shkak të godinës që është, të bëhet pavjon pas pavjoni.

Varianti i dytë që kemi propozuar, me mbështetjen e kryetarit të bashkisë, është të hapim një kioskë të madhe muzeore, siç është varianti i restaurimit të muzeut të Amsterdemit, ku u hap një kioskë jashtë me të gjithë parametrat. Ndërkohë që vizitorët vinin, u thoshin që muzeu është këtu dhe është duke u restauruar.

Fidel Ylli – Ky investim do të jetë vetëm për pjesën brenda apo edhe për fasadën e jashtme të muzeut?

Dorian Koçi – Fasada e jashtme e muzeut, pra mozaiku, do të restaurohet dhe do të silllet në fazë më të plotë. Po kështu, edhe tarraca e Muzeut Historik Kombëtar do të pësojë një ndryshim, në kuptimin që do të bëhet një nga pikat kryesore, sipas një plani të bashkisë, për marrjen e energjisë diellore, si dhe një vend i hapur për vizitorët, si edhe oborri i brendshëm. Janë parë disa variante deri tani. Njëri variant është që të jetë në mes një strukturë cilindri, e cila, si nëpër muzetë italiane, bën të mundur hyrjen e vizitorëve, pastaj shkuarjen në të gjitha vendet, por që nuk do ta tejkalojë lartësinë e muzeut, sepse ky është një monument i trashëgimisë kulturore i kategorisë nr. 2, gjë që do të thotë se nuk mund të ndryshohen lartësitë apo të gjitha të tjerat. Këto janë projekt arkitekturore, të cilat janë duke u parë.

Milva Ekonomi – Domethënë, në këtë moment ne kemi vetëm një fond, i cili bën të mundur hartimin e një projekti. Projekti ka disa skenarë. Skenari definitiv nuk është vendosur ende. Me t'u vendosur skenari, do të hartohen kostot.

Dorian Koçi – Skenari definitiv nuk është vendosur, por nga grupi i specialistëve që janë përzgjedhur, do të vazhdojë e njëjta linjë konceptuale, sepse janë parë nga parahistoria, dhe profesor Muhameti mund t’jua thotë më mirë, nga paleoliti i hershëm deri në momentet moderne të Shqipërisë. Sepse në një moment ishte për t’u diskutuar si një muze i qytetërimeve, por ai linte jashtë disa aspekte të rëndësishme të historisë së shqiptare, pra merrej me etnografinë, me arkeologjinë dhe me ikonografinë. Por mënyra e shtetndërtimit të Shqipërisë, siç është Pavarësia, Rilindja Kombëtare mbeteshin jashtë. Duke mos pasur muze të tjera, krijonte një vakuum. Pra, grupi i punës që është ngritur, pas disa debatesh, e reflekton të gjithë këtë linjë muzeore. Kjo do të thotë se kjo do të mbetet në atë linjë muzeore. Pastaj kostot e ndërtimit janë kosto, të cilat unë besoj që, me sa kam informacion, ndoshta qeveria shqiptare do të japë një lot, që mund të shkojë 4-5 milionë euro. Pastaj tjetri do të ngrihet me donacione.

Bujar Çela – Për procedurë. Unë e mora përgjigjen e pyetjes...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – A ka nevojë që për materialet historike, të rikorrigjohen retushimet që janë bërë?

E dyta, një shqetësim që e shoh të shprehur midis miqsh dhe vizitorësh të huaj, por edhe vendas, është se periudha e realizimit socialist pothuajse është fshirë dhe mungon, sikurse edhe ajo pas tranzicionit, sepse po kalojnë 30 vjet dalëngadalë.

Dorian Koçi – Ai është një rikonceptim i përgjithshëm.

Janë dy ide për realizimin e kësaj gjëje. E para, marrja e një fondi nga Muzeu i Arteve të Bukur i pikturave të realizimit socialist. Në këtë rast ne i shmangemi debatit shumë të nxehtë për atë të kaluar.

Një rast tjetër është ndërtimi i një pavijoni. Dua të them se në dialogun për kaluarën, Muzeu Historik Kombëtar është një nga promotorët, por jemi shumë më parë se vendet e tjera të Europës Juglindore, me përjashtim të Polonisë dhe të Gjermanisë. Ne zëmë vendin e tretë që kemi hapur më shumë... Pra, kemi itinerarin e rrugëve të memorieve, të kujtesës. Ndonjëherë fjalët që dalin në publik nga grupe të shumta interesi, që thonë se nuk po bëhet gjë, mund t’i përgënjeshtroj shumë kollaj.

Fidel Ylli – Nga varen këto të tjerat që janë hapur, si Shtëpia më Gjethe?

Dorian Koçi – Varet nga Ministria e Kulturës.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ka një iniciativë të shoqërisë civile, të deputetëve që kanë mbjellë nga një pemë te pjesa e burgut të Spaçit, që është burgu më i vështirë që ka pasur Shqipëria në kohën e komunizmit. Kemi edhe dy muze të tjera, të cilat nuk janë në hartën e muzeve

kombëtare, Bunkart 1 dhe Bunkart 2, tek të dyja kemi këtë pjesën e rregullimit të retushimit. Te Bunkart 1 shikon si bëhej gati diktatura për vetëmbrojtje, kurse te Bunkart 2 shikon se çfarë bënte diktatura për popullin. Nuk e di nëse i keni parë këto. Mund të vendosim t'i shohim bashkërisht të dyja muzetë, që është pjesa e rregullimit të retushimit. Ndërkohë, për mua vizita e Papës ka qenë kulmi i gjithë kësaj përjasje pozitive që ka bërë qeveria aktuale, për të konsideruar që periudha e komunizmit ka qenë vërtet e vështirë dhe këto janë gjërat që ndodhin në Shqipëri. Besoj se edhe këtu do të ketë një vëmendje.

Ismet Beqiraj – Brezi i ri do të njohë edhe mëkatet, edhe të mirat.

Milva Ekonomi – Po, mëkatet janë atje.

Fadil Nasufi – A keni ju një listë me dokumente që mund të ndodhen jashtë shtetit ose në territorin jashtë Shqipërisë, që duhet të vijnë këtu, të cilat duhet kenë statusin e muzeut kombëtar?

Dorian Koçi – Ne kemi një listë dhe i kemi identifikuar në rastin e Ditës Ndërkombëtare të Trashëgimisë, duke hapur një ekspozitë me foto të shumë objekteve të marra nga kulturua shqiptare, të cilat janë nëpër muzetë e botës, por marrja e tyre është shumë e vështirë.

Milva Ekonomi – Po digjitalizimi i këtyre objekteve si po ecën?

Dorian Koçi – Ne kemi pasur një projekt me Fondin Amerikan të Zhvillimit, që bëri disa projekte dhe me rikonceptimin e tij është menduar që në Muzeun Historik Kombëtar të ndërtohet fondi i përgjithshëm i digjitalizimit të tyre. Jemi në diskutime të përhershme, por ne e dimë që Fondi Amerikan i Zhvillimit ka edhe një filozofi tjetër, pra kërkon që ajo, për të cilën investon, të jetë edhe komerciale, pra të punësojë disa njerëz dhe të sjellë disa të ardhura...

Milva Ekonomi – Nuk ka njerëz nga stafi që janë përgjegjës për të bërë digjitalizimin e objekteve që keni këtu?

Dorian Koçi – Njerëz kemi, por po themi për teknikën më të lartë të aparaturave, të cilën nuk e zotërojmë. Digjitalizimi vazhdon, plotësimi i kartelave ka vazhduar, sepse, për hir të së vërtetës, i kemi gjetur pothuajse bosh. Investimi më i fundit që do të bëjmë me fondet tona është pikërisht konceptimi edhe njëherë dhe rivlerësimi i *sajtit* tone, që të bëhet si ai i Luvrit ose i muzeut britanik tredimensional, që të gjitha objektet tona të jenë tredimensionale, të cilat ne i pasqyrojmë aty. Jemi në diskutim me Ministrinë e Kulturës për gjetjen e mundësisë që të shtojmë disa të ardhura, sepse do të digjitalizojmë kartelat tona studimore. Kjo do të thotë që një studiues që është në Amerikë, në qoftë se kërkon të studiojë për Ilirinë, nuk ka pse të vijë në Shqipëri, por gjen në 3D objektin. Por për të arritur këtë gjë, duhet të klikojë dhe të paguajë në llogarinë e muzeut 3 euro ose 5 euro, që është puna jonë kërkimore-shkencore, të cilën nuk

mund ta japim falas. Na duhet të zgjidhim nga ana teknike me Ministrinë e Kulturës se si do të menaxhohen këto të ardhura, nëse do t'i mbeten tërësisht muzeut apo do të jenë përsëri 30% me 70% dhe Ministria e Kulturës duhet të flasë me Ministrinë e Financave.

Milva Ekonomi – Kolegë, a keni pyetje të tjera? Edhe Muhameti na e kujtoi përpjekjen që bëmë ne te ligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” për të futur aty statusin e veçantë të Muzeut Kombëtar. Këtë nuk mund ta bënim pa ndihmën tuaj, i dashur drejtor, sepse komunikimi që bëmë me ju, na bindi që duhet ta vendosim këtë nen të veçantë.

Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera, falënderojmë stafin dhe drejtorin për këtë organizim!

Vizita vijon në pavionin e hapur me rastin e Vitit të Skënderbeut.

MBYLLET MBLEDHJA